



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT
TIRANË**

**Nr. 230 i Regj. Themeltar
Nr. 191 i Vendimit**

**V E N D I M
“ N Ë E M Ë R T Ë R E P U B L I K Ë S ”**

Gjykata e Apelit Tiranë e përbërë prej :

**KRYESUES : TOM NDRECA
ANËTAR : FATOS QATO
ANËTAR : ASTRIT HAXHIALUSHI**

Asistuar nga sekretare gjyqsore *Klodiana Kryeziu*, sot më datë 22.02.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, si gjykatë e shkallës së dytë, çështjen penale që i përket :

I PANDEHUR: **Gjon Gjoka** i biri i Zefit dhe i Daves dtl 11.03.1992, lindur ne Mirdite dhe banues ne Kamez,rruga per ne Laknas, me arsim 8 klase,beqar,shtetesi e kombesi shqiptare,I padenuar me pare, hetuar e gjykuar me mase sigurimi “arrest me burg”.

AKUZUAR: Kryerjen e veprave penale te “Vjedhjes me dhune” ne bashkupnim, ne dem te shtetasit Ilmi Sina, si dhe “Vjedhje me dhune” ne dem te shtetasit Qemal Tufa , vepra penale te parashikuara nga nenet 139 e 25 dhe 139 te K.Penal.

I PANDEHUR: **Vladimir Kurti** i biri i Petritit dhe i Lirise dtl 01.02.1990,lindur ne Mat dhe banues ne Kamez,me arsim 8 klase,beqar,shtetesi e kombesi shqiptare,I

padenuar me pare, hetuar e gjykuar me mase sigurimi “arrest ne burg” perfaqesuar nga avokatet e tij Ardian Visha dhe Arben Prenga.

AKUZUAR:

Per kryerjen e vepres penale te “Vjedhjes me dhune” ne bashkpunim, ne dem te shtetasit Ilmi Sina, parashikuar nga neni 139 e 25 te K.Penal.

I PANDEHUR:

Hysen Daci, i biri Agronit dhe i Liries i dtl 1991, lindur ne Kukes dhe banues ne Kamez Tirane, shtepi private pa nr, me arsim 8 klase, shtetesi e kombesi shqiptare, beqar, I padenuar me pare, hetuar e gjykuar ne mase sigurimi “arrest ne burg”.

AKUZUAR:

Per kryerjen e vepres penale te “Vjedhjes me dhune” ne bashkpunim, ne dem te shtetasit Ilmi Sina, parashikuar nga neni 139 e 25 te K.Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimin Nr.1234 date 26.-07.2011 ka vendosur si vijon:

1. Deklarimin fajtor te te pandehurit Gjon Gjoka per kryerjen e vepres penale te “Vjedhjes me dhune” ne bashkpunim ne dem te shtetasit Ilmi Sin dhe ne baze te nenit 139 dhe 25 te K.Penal e denon me 5 vjet burgim.
2. Deklarimin fajtor te te pandehurit Gjon Gjoka per kryerjen e vepres penale te “Vjedhjes me dhune” ne dem te shtetasit Qemal Tufa dhe ne baze te nenit 139 te K.Penal e denon me 5 vjet burgim.
3. Ne bashkim te denimeve ne baze te nenit 55 te K.Penal te pandehurin Gjon Gjoka e denon me 6 vjet burgim.
4. Ne zbatim te nenit 406 te K.Pr.Penale te pandehurin Gjon Gjoka perfundimisht e denon me 4 vjet burgim.
5. Vuajtja e denimit per te pandehurit Gjon Gjoka fillon me date 31.12.2010.
6. Denimin ta kryej ne nje burg te sigurise se zakonshme.
7. Deklarimin fajtor te te pandehurit Vladimir Kurti per kryerjen e vepres penale te “Vjedhjes me dhune” ne bashkpunim ne dem te shtetasit Ilmi Sin dhe ne baze te nenit 139 dhe 25 te K.Penal e denon me 5 vjet burgim.
8. **Ne** zbatim te nenit 406 te K.Pr.Penale te pandehurin Vladimir Kurti

- perfundimisht e denon me 3 vjet e 4 muaj burgim/
9. Vuajtja e denimit per te pandehurin Vladimir Kurti fillon me date 12.01.2011.
 10. Denimin ta kryej ne nje burg te sigurise se zakonsnshme.
 11. Deklarimin fajtor te te pandehurit Hysen Daci per kryerjen e vepres penale te “Vjedhjes me dhune” ne bashkpunim ne dem te shtetasit Ilmi Sina dhe ne baze te neni 139 dhe 25 te K.Penal e denon me 5 vjet burgim.
 12. Ne zbatim te nenit 406 te K.Pr.Penale te pandehurin Hysen Daci pefundimisht e denon me 3 vjet e 4 muaj burgim.
 13. Vuajtja e denimit fillon me date 31.12.2010.
 14. Denimin ta kryej ne nje burg te sigurise se zakonsnshme.
 15. Shpenzimet procedurale dhe gjyqsore tju ngarkohen te pandehurve ne menyre solidare.

Kunder vendimit ka bere ankim vetem I pandehuri Vladimir Kurti dhe vetem per menyren e vuajtjes se denimit me burgim duke aplikuar nenin 59 te Kodit Penal (pezullim te egzekutimit te denimit me burgim) per shkaqet:

- Une kam pranuar fajesine dhe jam treguar I penduar qe ne fillese te kontakteve me autoritet e procedimit.
- Nga gjykata nuk jane vleresuar, drejte nje sere rrethanash lehtesuese parashikuara nga neni 48 germat “ç”, “dh” dhe “e” te K.P.
- Kemi normalizuar marredheniet me te demtuarin.
- Jam I padenuar me pare.

GJYKATA APELIT TIRANE

Si degjoi relatorin Tom Ndreca, prokurorin Edmond Hyka qe kerkoi lenien ne fuqi te vendimit, tre te pandehurit prezent ku per te pandehurin ankues Vladimir Kurti, prej tij dhe Av.Ardian Visha u kerkua,zbatimi I nenit 59 te Kodit Penal dhe si vleresoj aktet ne dosje,

VEREN

Vendimi penal Nr.1234, dt.26.07.2011 i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte I drejte , I bazuar ne ligj e ne prova dhe si I tille duhet lene ne fuqi. Ky vendim duhet lene ne fuqi ne te gjitha pjeset e tij, pra dhe per te pandehurin Vladimir Kurti, I cili e ka ankimuar ate sepse:

Eshte provuar ne gjykim dhe pranuar edhe nga vete te pandehurit Gjon Gjoka, Hysen Daci e Vladimir Kurti se ata ne dy raste kane kryer vepren penale te “Vjedhjes me dhune “, ne bashkepunim parashikuar nga nenet 139 e 25 te K.Penal.

Keshtu tre te pandehurit te njohur dhe shoke me njeri tjetrin me dt.31.12.2010 kane marre si sherbim taksie, shtetasin e demtuar Ilmi Sina, i cili kishte , ne pronesi te tij automjetin taksi me targe TR 411 C tek vendi i quajtur “Piacca” Tirane. Pasi jane nisur per ne Bathore, tek rreth rrotullimi e kane kercenuar me nje thike dhe marre telefonin celular e leket qe kishte me vete. Me pas te demtuarin Ilmi nen kercenimin e pasojes ekstreme e kane kaluar ne sediljen e pasme te mjetiti dhe drejtimin e tij e ka marre I pandehuri Gjon Gjoka duke u nisur per ne autostraden Tirane –Shkoder. Gjate rruges automjeti eshte perplasur me nje shtylle , ngjarje ne te cilen kane mbetur te plagosur si te pandehurit Gjon Gjoka e Hysen Daci por dhe taksisti Ilmi Sina. Kjo ka qene momenti ku jane arrestuar te pandehurit Gjon Gjoka e Hysen Daci te cilet me pas kane pranuar e sqaruar se me te ka qene dhe i pandehuri Vladimir Kurti, fakti i pranuar dhe nga vete Vladimiri.

Po ne gjykim eshte provuar se i pandehuri Gjon Gjoka edhe me dt.29.12.2010, ne vendin e quajtur “Bathore “, Kamez me dhune ka vjedhur taksine me targa TR 345 B ne pronesi te shtetasit Qemal Tufa te cilen me pas e ka lene te braktisur ne Zall Mner , ne nje rrugice lagje.

Per epsiodet e mesiperme te vjedhjeve me dhune te tre te pandehurit jane deklaruar fajtor dhe denuar sipas dispozitave te vendimit Nr.1234, dt.26.07.2011 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ndaj vendimit, me ankim ka reaguuar vetem I pandehuri Vladimir Kurti I cili kerkon qe pjesa e mbetur e denimit te pavuajtur sipas nenit 59 te K.Penal, te pezullohet ne egzektuim, per shkaqet e lartepermendura.

Ky koleg j cmon se shkaqet per te cilat pretendohet se duhet aplikuar neni 59 KP jane vleresuar te atilla ne caktimin e mases se denimit mase kjo e dhene me kufirin minimal te dispozites materiale penale por ato nuk vleresohen te tilla qe permbushin kushtet e kriteret qe kerkon neni 59 i Kodit Penal.

Arrihet ne kete perfundim pasi rrezikshmeria shoqerore e vepres penale eshte shume e madhe vjedhje me dhune dhe e kryer ne bashkepunim. Gjithashtu rrezikshmeria e kesaj vepre dhe konkretisht ajo e vjedhjes me dhune te taksive duke i marre si te tilla fillimisht ne sherbimin qe ato kryejne e me pas vjedhja e tyre deri ne eliminimin fizik te taksixhijeve shtohet se tepermi si shkak i perhapjes se madhe te saj, jo vetem ne Tirane por ne gjithe

Shqiperine.

PER KETO ARSYE

Gjykata e Apelit Tirane bazuar ne nenin 428 pika 1 germa “a”te K.Pr.
Penale,

VENDOSI

Lenien ne fuqi te vendimit Nr.1234, dt.26.07.2011 te Gjykates se Rrehtit
Gjyqesor Tirane.

Tirane me 22.02.2011

**ANETAR
A.HAXHIALUSHI**

**ANETAR
F.QATO**

**KRYESUES
T.NDRECA**

[Shqiptaria.com]